


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT "ERGYS M. SINANI"

Nr.385 Prot  
Nr. 105 Dosje

Tiranë, më 15/07/2020

URDHËR

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)



**Drejtuar:** QËNDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

*Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë*

**Për dijëni:** Debitori - Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. me NUIS - L72031013B

*Adresa: Njesia Administrative Nr.5, Bulevardi Gjergj Fishta, Nr.48, Tiranë*

**Për dijëni:** Kreditorit – Shoqëria "I.X.H.E.M." sh.p.k, me NUIS- K81921503A

*Adresa :Rrashbull, Vrrinë, prane rruges se Fshatit Rinia, Durrës*

Unë, Ergys M. Sinani , me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 2474 Akti datë 18.6.2020 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.105 , datë 23.06.2020 kërkesën e kreditorit Shoqëria " I.X.H.E.M. " sh.p.k, ndaj debitorit Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., me NUIS - L72031013B në lidhje me titullin ekzekutiv "Faturën Tatimore me nr.serial 66481091 datë 11.04.2019 lëshuar sipas situacionit per kontraten e nensipermarrjes dt. 02.10.2018".

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 366 Prot, datë 23/06/2020, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 2474 Akti datë 18.6.2020 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOVA Se :**

Debitori Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., me NUIS - L72031013B, ka marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., me NUIS - L72031013B,në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve pika (b), 37 pikat (b ; c) dhe 46 të Ligjit Nr.26/2019, datë 8.5.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

## URDHËROJ

1. Qëndrën Kombëtare të Biznesit , të bëjë bllokimin e kuotave / aksioneve / aktiveve apo çdo të drejtë tjetër në subjektin tregëtare me të dhëna :
  - ✓ Shoqëria ``**Integrated Energy BV SPV**`` sh.p.k., me NUIS - L72031013B, *adresë* Njesia Administrative Nr.5, Bulevardi Gjergj Fishta, Nr.48, Tiranë
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së kuotave/aksioneve apo çdo të drejtë tjetër në emër të debitorit të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Proçedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër ) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

Ergys M. Simani

